

**SHOQERIA TREGTARE ME ORTAKERI**  
ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

**“VEZI GROUP” Sh. p. k.**

Durres – Albania

**KONTRATE THEMELIMI**

Ne Durres, sot me daten 19/01/2015(dymije e pesembedhete), dite e Hene, un shtetasi shqipetar me kete identitet:

**1. Z. Blerim Vezi**, atesia Artur , amesia Mimoza, i datelindjes 11.08.1995, lindur ne Maminas Durres dhe banues ne fshati Sallmone komuna Xhafzotaj Shijak Durres, nr tel 0673514784, duke u bazuar ne:

- \* Vullnetin tim te lire, te plote, te sinqerte, mirekuptues dhe ne inisiativen e lire private,
- \* Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi,
- \* Ne Ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 “Per Shoqerite Tregtare”,
- \* Ne Ligjin Nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit”

**NENI 1**

Shoqeria formohet nga Un Ortaku themelues me emrin “**VEZI GROUP**” Shpk Durres-Albania, emertim i cili do te jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

**NENI 2**

Selia Qendrore e Shoqerise “**VEZI GROUP**” Shpk eshte ne Durres ne adresen: Fshati Sallmone komuna Xhafzotaj, Rruga ish SMT-ja, nr baneses 021 , Shijak Durres zona kadastrale 3255, Tel.: 067 3514784

**NENI 3**

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj tregetar ne te gjithe juridiksionin territorial te Republikes se Shqiperise si dhe jashte shtetit ne cdo vend te Komunitetit European, etj.

Me Vendim te Asamblese se Ortakeve mund te krijohen ose anulohen (ne rast se jane celur) Seli, Filiale, Agjensi dhe Perfaqesi si ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte shtetit.

Njesite e tjera Strukturore te Shoqerise, si Dege apo Perfaqesi dhe jashte shtetit krijohen kur nje gje te tille e parashikon dhe lejon edhe legjislacioni i vendeve te huaja, **normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve te ndryshme.**

**NENI 4**

**Kapitali Themeltar** i Shoqerise eshte **100.000 Lek** (njqindemije) Lek, i formuar dhe nenshkruar nga Ortaku Themelues i ndare ne **100 kuota**, me vlere nominative **1.000 lek/1 kuote**, ku nje kuote eshte e barabarte me 1 vote me te drejte vendimore dhe sipas ketij kontributi financiar:

**1. Ortaku z. Blerim Vezi** gezon kuotat e tij ne shoqeri ne perpjestim me kontributin qe ka dhene ne kapital. Ky kontribut eshte ne shumen **100.000 lek** si pasoje ortaku i vetem zoteron 100 kuota, e barabarte me 100% te votave me te drejte vendimore dhe qe zene **100% te Kapitalit** themeltar.

Blerim Vezi

Ortaku ka pavaresi ligjore, organizative si dhe te drejta pronesie mbi çdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjeter te fituar ne rruge te ligjshme.  
Shoqeria pergjigjet vetem me Kapitalin e saj.

#### NENI 5

Kapitali nuk mund te jete kurre i perfaqesuar me Letra me vlere dhe derdhja e Kapitalit themeltar te Shoqerise, behet para kerkeses drejtuar **Qendres Kombetare te Rregjistrimit** per njohjen dhe rregjistrimin e saj si Person Juridik.

#### NENI 6

**Kohezgjatja** e ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise eshte **PA AFAT**, duke filluar aktivitetin e saj nga dita e Shpalljes se saj Person Juridik.

Me Vendim te Asamblese se Ortakeve kohezgjatja e ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise mund te ndryshoj, dhe ky Vendim i dergohet menjehere per depozitim Qendres Kombetare te Rregjistrimit, kompetente per te bere shenimet e nevojshme ne Rregjistrin e Shoqerive Tregtare.

#### NENI 7

Shoqeria e zhvillon veprimtarin e saj tregtare ne perputhje te plote me Legjislacionin shqiptar ne fuqi si dhe mbi bazen e kesaj Kontrate Themelimi si dhe Statutin e saj.

#### NENI 8

Shoqeria çel Llogari Bankare ne leke vendi dhe çdo lloj valute, ne Banka vendase ose te huaja, private apo shtetore, me qellim per te kryer veprimet e nevojshme per ushtrimin dhe perballimin financiar te aktivitetit te saj.

Ortaket dhe Administratori Pergjithshem i caktuar prej tyre, depozitojne faksimilet e firmave te tyre origjinale ne Bankat ku eshte çelur llogaria dhe terheqja e pjeseve te saj behet kur Çeku bankar eshte firmosur nga njeri Ortak qe eshte caktuar dhe Administratori i Shoqerise, dhe ne rastin kur Ortaket kane caktuar me shume se nje Administrator, i cili eshte jashte ortakerise, ceku bankar dhe cdo likuidim apo pagese nenshkruhet nga Ortaku qe eshte Administrator i Pergjithshem i Shoqerise dhe nga Administratori jashte Shoqerise.

#### NENI 9

**Pjeset e Kapitalit Themelor**, jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie sipas dispozitave te Kodit Civil.

Ortaket kane te drejte qe te transferojne jashte territorit te Republikes Shqiperise pjeserisht apo teresisht Kontributet e saj perfshire dhe Fondet e Kontributet ne natyre.

Transferimet e pjeseve te Kapitalit Themelor, duhet te jene te vertetuara me Kontrate Noteriale dhe per nje gje te tille Ortaket duhet te marrin paraprakisht Vendim me shkrim, i cili ushtron efektet juridike vepruese te tij, vetem ne rast se eshte legalizuar nga nje Noter.

Shoqeria dhe te tretet, duhet te respektojne keto Transferime sapo tu behen te ditura.

## NENI 10

### **Shoqeria krijohet per te ushtruar aktivitetin e saj tregëtar ne keto Drejtime:**

**1. Investim dhe Menaxhim** ne fushen e veprimtarise ndertimore, per ndertimin e cdo lloj godine nje ose shumekateshme, Civile, industriale, turistike, bujqesore, qendra biznesi, Hotele, Bar – Restorante, kompletme dhe instalime te nevojshme per to, ndertime, mirembajtje dhe vepra arti te rrugeve te cdo kategorie, perfshire dhe autostrada veshje me asfaltobeton te rrugeve (ndertim mbishtruse), sistemim e asfaltim sheshesh, ndertim pista e aeroporte, ndertime hekurudhore, ndertime vepra arti rrugore dhe hekurudhore, ndertime detare, sikurse jane ndertimet portuale, basena punime thellimi ne porte dhe zgjerim kalatash etj.

**2. Investim dhe Menaxhim** per ndertimin e urave, çeljen dhe perfundimin e rrugeve te reja, te autostradave te komunikacionit urban dhe interurban, asfaltimin e tyre, si brenda vendit dhe jashte shtetit kryerjen e veprave te artit ne perputhje me infrastrukturen bashkekohore.

**3. Çeljen dhe ushtrimin** e aktivitetit te agjensive imobiliare, me qellim realizimin e shitblerjeve dhe dhenien me qera te pasurive te paluajtshme, me ndodhje ne juridiksionin tokesor administrativ te shtetit Shqiptar, si dhe ushtrimin e aktivitetit koncesionar brenda dhe jashte vendit, si dhe celjen dhe ushtrimin e aktivitetit te agjensive turistike.

**4. Investim, menaxhim dhe ndertime Mbrojtese** e punime sistemimi kunder grryerjeve lumore, liqenore, detare te rezervuareve pellgmbajtes, kryerje punimesh per germime dheu me mjete te mekanizuara, hapje tunelesh dhe kryerje punimesh avancimi dhe perforcimi ne to, te prodhimeve pilote dhe elementeve te tjere betonarme, **prodhim guri per skolierat ne ndertimet PORTUALE**, punime çimentimi dhe te injektimeve detare, shtrirje kabllosh e tubacionesh nenujore per naften e gazin etj.

**5. Import – Eksportin** dhe tregëtimin me shumice dhe pakice te materialeve te gjithllojshem ndertimore, te teknologjive dhe mjeteve te mekanizuara per nevojat e ndertimit te paisjeve e materialeve hidrosanitare, elektrike, te axhensoreve, dyerve blindate, te prodhimeve prej duralumini e te pjesve te ndryshme te kembimit per çdo makineri apo paisje, si dhe çeljen e reparteve dhe linjave te prodhimit per to, brenda vendit e jashte shtetit, si vetem dhe ne kooperim dhe bashkepunim me firma private te Huaja.

**6. Import – eksportin** dhe tregëtimin me shumice e pakice te mallrave te ndryshme industriale artikujve ushqimore, blektorale, bujqesore dhe te cdo lloj malli tjetër te lejuar per tregëtim.

**7. Marrjen pjese ne Panaire kombetare dhe nderkombetare**, qe kane te bejne me çeljen dhe zhvillimin e biznesit, ne fushen e ndertimit dhe te teknologjise bashkekohore te tij, me qellim jo vetem ekspozimin e games se prodhimeve ndertimore te firmes por dhe per te mundesuar arritjen e

marrveshjeve kontraktore me persona juridik vendas dhe te huaj per zgjerimin apo kooperimin e aktivitetit te perbashket tregëtar me to, si dhe **pjesmarrje ne Tendera brenda e jashte vendit.**

## NENI 11

Me Vendim te Asamblese se Ortakeve, Shoqeria mund te zgjerohet duke pranuar nje ose me shume ortake te tjere, shtetas shqiptar apo te huaj, ose te bashkohet me nje Shoqeri tjetër tregëtare si brenda vendit dhe jashte shtetit.

## NENI 12

**Asambleja e Ortakeve** eshte Organi me i larte Drejtues dhe Vendimor i Shoqerise dhe ajo ushtron te gjitha kompetencat qe Ligji “Per Shoqerite Tregëtare” i njej Asamblese se Ortakeve qe jane krijuar me Ortakeri.

Ortakët në mirëkuptim dhe duke vënë paraprakisht në dijeni njëri tjetrin mund t'ja delegojnë Kompetencat një ose me shumë Administratoreve të caktuar prej tyre ose dhe një Personi fizik apo Juridik, vëndas apo të huaj dhe jashtë ortakërisë së Shoqërisë, mbi bazën e Prokures, të bërë me akt noterial.

#### NENI 13

Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë, caktohet :  
**Z. Blerim Vezi**, atësia Artur, amësia Mimoza, i datelindjes 11.08.1995, shtetas shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në fshat Sallmonë komuna Xhafzotaj, Shijak Durrës.

#### NENI 14

**Kjo Kontratë Themelimi** u redaktua në 5 ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe dhe është i vlefshëm de jure, kur në të gjithë faqet e tij është vënë emri, mbiemri dhe firma origjinale e Ortakëve Themelues dhe kur autenticiteti i nënshkrimit është vërtetuar nga noteri.

ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË TREGTARE

**“VEZI GROUP” SH.P.K**

MIRATUES I KESAJ KONTRATË THEMELIMI

1. Z. Blerim Vezi

